

Cité internationale des arts

Shtëpi

**Galeria Kombëtare e Kosovës
x Cité internationale des arts**

Laureatët 2026

Galeria Kombëtare e Kosovës (GKK) dhe Cité internationale des arts kanë kënaqësinë të njoftojnë përzgjedhjen e laureatëve të programit të përbashkët të rezidencave artistike, që shënon fillimin e këtij bashkëpunimi , si dhe prezanton ekspozitën e ardhshme në GKK-QAFA.

Lansuar në shtator 2025, **Shtëpi** është një program inovativ rezidence për artistë të të gjitha disiplinave që jetojnë dhe punojnë në Kosovë. Me synim që të nxisë shkëmbimet në nivel ndërkombëtar, të zgjerojë rrjetet profesionale dhe artistike, si dhe të zhvillojë praktikën artistike përmes mbështetjes së dedikuar për kërkim, prodhim dhe dukshmëri, programi ofron një rezidencë tre-mujore në Paris (3 mars – 28 maj 2026) dhe mundësinë për të prezantuar punën në ekspozitën kolektive në Galerinë Kombëtare të Kosovës – QAFA, kuruar nga Hana Halilaj (11 dhjetor 2025 – 19 shkurt 2026).

Rezidenca përfshin mbështetje profesionale të personalizuar, rrjetëzim me artistë dhe profesionistë të artit me bazë në Francë, si dhe integrim në komunitetin e larmishëm ndërkombëtar të krijuesve të Cité internationale des arts.

Ky bashkëpunim në mes Galerisë Kombëtare të Kosovës dhe një prej institucioneve kryesore të rezidencave artistike në Paris mishëron një angazhim të përbashkët për dialog ndërkulturor, praktika artistike bashkëkohore dhe qarkullim global të ideve. Struktura e kombinuar e ekspozitës dhe rezidencës u mundëson artistëve të realizojnë vepra të reja ambicioze, të arrijnë audienca të reja dhe të ndërtojnë trajektore të qëndrueshme artistike.

“Një përvojë rezidence e tillë shpesh shënon një moment kyç në karrierën e një artisti: ajo ofron kohë dhe hapësirë të dedikuar për eksperimentim, shkëmbim dhe reflektim. Në Cité, artistë nga e gjithë bota bëhen pjesë e një komuniteti të jashtëzakonshëm krijuesish, që punojnë përtej disiplinave dhe kulturave. Ky mjedis nxit bashkëpunimin, dialogun dhe perspektiva të reja, duke fuqizuar zhvillimin personal dhe artistik. Ne jemi krenarë që mirëpresim artistët nga Kosova në këtë projekt dinamik dhe ambicioz.”

**— Vincent Gonzalvez,
Drejtor i Rezidencave, Programi i Arteve dhe Kulturës dhe Komunikimit,
Cité internationale des arts**

“Përmes partneritetit me Cité internationale des arts dhe programit të rezidencës Shtëpi, Galeria Kombëtare e Kosovës vazhdon të mendojë për rolin e saj jo vetëm si një hapësirë ekspozuese, por edhe si një kontekst aktiv për krijim dhe shkëmbim. Programi synon të mbështesë prodhimin artistik dhe t’u ofrojë artistëve kohë dhe hapësirë për të zgjeruar praktikat e tyre dhe në të njëjtën kohë hap rrugë për dialog dhe bashkëpunim. Realizuar në kuadër të Cité internationale des arts, e njohur për përkushtimin e saj afatgjatë ndaj kërkimit artistik dhe shkëmbimit ndërkombëtar, kjo nismë përbën një mundësi të jashtëzakonshme për të kontekstualizuar artistët kosovarë brenda një rrjeti më të gjerë të praktikave bashkëkohore globale.”

— Hana Halilaj, Kuratore, Galeria Kombëtare e Kosovës

Pas vlerësimit të aplikimeve nga një juri profesionistësh të artit bashkëkohor, Kreshnik Arifi, Lumturie Krasniqi dhe Renea Begolli, janë përzgjedhur si lauretatët e vitit 2026 të edicionit të parë të Shtëpi.



Lumturie Krasniqi (b. 1997) është artiste pamore me bazë në Prishtinë, Kosovë. Ajo ka përfunduar studimet në pikturë në Akademinë e Arteve në Prishtinë. Punon kryesisht në mediumin e pikturës, por eksploron gjithashtu fotografinë, instalacionin dhe artin digjital. Praktika e saj artistike thellohet në aspekte shpesh të anashkaluara të jetës bashkëkohore, duke ngritur pyetje ekzistenciale dhe duke eksploruar ndërveprimin mes të kundërtave — lidhje dhe ndarje, shpirt dhe materie, frikë dhe dashuri, njerëzim dhe natyrë. Krasniqi ka ekspozuar punët e saj në një sërë ekspozitash, përfshirë Silent Threads, Resounding Kosova, GALLERIA CONTINUA / Paris (2025); Awakening — Bialja e 14-të e Artistëve të Rinj, Muzeu i Artit Bashkëkohor, Shkup (2023); dhe MANIFESTA 14 Biennale, Prishtinë (2022).



Kreshnik Arifi (b. 2000) është artist pamor me bazë në Prishtinë, Kosovë. Ai ka përfunduar studimet Bachelor në Fakultetin e Arteve, në Departamentin e Artit Konceptual dhe Medias së Re, ku aktualisht ndjek studimet Master. Praktika e Arifit lidh artin pamor, muzikën dhe arkitekturën, duke eksploruar potencialin komunikues të zërit përmes burimeve jokonvencionale dhe “naive”. Këta tinguj, të çliruar nga struktura gjuhësore, shndërrohen në mjete për ndërtimin e formave të reja komunikimi. Në këtë proces, ai ndërthur tingullin me imazhin lëvizës dhe elemente arkitektonike për të drejtuar dhe rindërtuar rrjedhën narrative. Së fundmi ka prezantuar *Something’s about to happen*, *Brick Factory*, Prishtinë (2025), dhe *The Bridge of the City Without a Bridge (as a vision)*, Kino Armata (2024).



Renea Begolli (b. 1998) është artiste pamore dhe hulumtuese me bazë në Prishtinë, Kosovë. Praktika e saj përfshin pikturën, videon, instalacionin, vizatimin, tingullin dhe kërkimin arkivor, duke eksploruar ndërthurjet midis gjinisë, kujtesës, ekologjisë dhe trupit. Duke u mbështetur në perspektiva feministe dhe ekofeministe, ajo shqyrton politikën e dukshmërisë, trupëzimit dhe ndërmjetësimit digjital. Ka përfunduar studimet Bachelor dhe Master në Pikturë në Universitetin e Prishtinës dhe është fituese e Çmimit Artistët e së Nesërme 2023, organizuar nga Stacion – Qendra për Art Bashkëkohor. Begolli ka ekspozuar punimet e saj në All this time, becoming, Fondacioni Hajde!, Prishtinë (2025); What Are You Waiting For?, Nju Jork (2024); dhe Pragu, Galeria Qahili, Prishtinë (2023).

Rreth GKK

E themeluar në vitin 1979, Galeria Kombëtare e Kosovës është institucioni kryesor në vend i dedikuar për artin modern dhe bashkëkohor. Misioni i saj është të mbështesë prodhimin artistik, të nxisë diskurs kritik dhe të ofrojë një platformë për artistë në ardhje dhe të njohur nga Kosova dhe më gjerë. Përmes ekspozitave, programeve publike dhe botimeve, Galeria angazhon audienca të ndryshme dhe luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e skenës kulturore në rajon. Institucioni ka një koleksion prej mbi 1,200 veprash, duke përfshirë medime si- pikturë, grafikë, skulpturë, video, fotografi dhe të tjera. Në vitin 2025, Galeria u zgjerua me hapjen e GKK – QAFA, një hapësirë e dytë e konceptuar si platformë eksperimentale dhe avangarde për artin bashkëkohor, me fokus në mbështetjen e artistëve të rinj, komisionimin e veprave të reja dhe organizimin e ekspozitave të para personale ndër të tjera; duke krijuar mundësi të reja për zhvillimin dhe prezantimin e praktikave të ndryshme artistike. Në vitet e fundit, Galeria ka zgjeruar vizionin e saj kuratorial, duke pritur gjithnjë e më shumë artistë rajonalë dhe ndërkombëtarë, ndërkohë që mbetet e përkushtuar ndaj mbështetjes së skenës lokale. GKK është poashtu institucioni komisionues i Pavijonit të Republikës së Kosovës në Bienalen e Venedikut, për Ekspozitën Ndërkombëtare të Artit dhe atë të Arkitekturës.



Rreth Cité internationale des arts

Cité internationale des arts është programi më i madh i rezidencave artistike në botë, që sjellë së bashku më shumë se 300 artistë dhe profesionistë të kulturës nga e gjithë bota, të brezave të ndryshme.

Që nga viti 1965, u ka ofruar rezidenteve të të gjitha disiplinave (arte vizuale dhe interpretuese, muzikë, film, arkitekturë, shkrim, etj.) mundësinë për të punuar në një projekt krijues ose kërkimor në zemër të Parisit. Gjatë periudhës prej dy muaj deri në një vit, Cité internationale des arts (një fondacion i njohur për shërbime publike) mirëpret rezidentët në lagjen Marais ose Montmartre në një mjedis që nxit kreativitetin dhe njëkohësisht ofron mundësi për takime dhe shkëmbime me profesionistë të tjerë të artit dhe kulturës dhe publikun e gjerë. Cité gjithashtu sigurohet që çdo artist të marrë mbështetjen që i nevojitet gjatë qëndrimit të tyre.

Në bashkëpunim me shumë partnerë, ajo hap disa thirrje për aplikime çdo vit mbi tema specifike dhe/ose për projekte specifike, ndërsa zhvillon programe për grupe të targetuara rezidencash. Përgjatë vitit, Cité organizon një program të pasur, multidisiplinor dhe protean arti (punëtori të hapura, ekspozita, koncerte, shfaqje, debate, etj.), duke promovuar punën e rezidentëve aktualë ose të mëparshëm dhe duke afirmuar rolin e rezidencës si një kohë për dialog dhe eksperimentim.



Cité internationale des arts

→ Marais Site
18, rue de l'Hôtel de Ville
75004 Paris

Cité internationale des arts
www.citeinternationaledesarts.fr

Shantal Menéndez Argüello
Menaxhere e Komunikimit
[shantal.menendezarguello@
citedesartsparis.fr](mailto:shantal.menendezarguello@citedesartsparis.fr)

Galeria Kombëtare e Kosovës
www.galeriakombetare-rks.co

Elsa Morina, Administratë
info@galeriakombetare-rks.com

Shtëpi

GKK x Cité internationale des arts



ACADÉMIE
DES BEAUX-ARTS
INSTITUT DE FRANCE



Shtëpi

GKK x Cité
internationale
des arts

